



Pranuar / Doretuar Puniljeno/Prodato Received/Delivered	31.12.2021	1	viti god year
Organ /Ibjesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	6476/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.989/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1107/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.119/2020 të datës 13.04.2020 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr."Marie Shllaku" nr.22, Pejë, kundër organit të punësimit Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, në çështjen juridike "Masë disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.119/2020 e datës 14.04.2020 e parashtruar nga ankuesja

II. Anullohet Vendimi me Nr.098 i datës 23.01.2020 i Komisionit Disiplinor dhe Vendimi Nr.627 i datës 16.03.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

III. Obligohet Sekretari Përgjithshëm në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, që të zbatojë këtë vendim në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njejtit, duke hequr nga dosja personale e ankueses masen e shqiptuar disiplinore dhe të njejtës t'i bëhet rimbursimi i mjeteve financiare të ndalura sipas Vendimit Nr.098 të datës 23.01.2020.

IV Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën "Zyrtare për Master dhe Doktoratur" në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, me datë 13.04.2020 përmes emailit ka parashtruar ankesë me numër protokollit 738/2020 të regjistruara me A.nr.119/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.098 të datës 23.01.2020 të Komisionit Disiplinor dhe Vendimit Nr.627 të datës 16.03.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.04.2020, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek organi i punësimit, ndërsa me datë 21.04.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.06.2020 përmes shkresës me numër të protokollit 1028/2020 e ka njoftuar ankuesen lidhur me pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e datës 13.04.2020 për shkak të mungesës se kuorumit dhe të njëjtin e ka udhëzuar që t'i ndjek procedurën e përcaktuar me dispozitat e LKA-se. Ankuesja, kundër këtij njoftimi ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit me numër A.nr.1107/2020 ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil që të shqyrtojë dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 13.04.2020 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 13.04.2020 me numër A.nr.119/2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 738/2020; Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me nr. A.nr.1107/20 të datës 17.11.2021; Fletëkthesë me nr. R8977422; Njoftim i datës 04.06.2020; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.05.2020; E-mail nga M.N. për L.C. i datës 29.01.2020; E-mail nga L.C. për M.N. i datës 29.01.2020; Vendim me nr. 098 i datës 23.01.2020; E-mail i datës 23.01.2020; E-mail i datës 23.01.2020; Vendim me nr. 627 i datës 16.03.2020; Ankesë me nr. 1364 e datës 04.12.2019; Kërkesë për marrjen e certifikatës dhe diplomës me nr. 3013 i datës 10.10.2018; E-mail nga M.N. për ankesa.kpmshck i datës 13.04.2020; Lista kontrolluese për studentët e studimeve master para diplomimit; Pliko me nr. R8915303 i datës 14.04.2020; Përgjigje në ankesë e datës 21.04.2020; E-mail i datës 13.12.2019; E-mail i datës 13.12.2019; E-mail nga A.A. për M.H. i datës 12.12.2019; E-mail nga M.H. për A.A. i datës 12.12.2019; E-mail nga A.A. për M.H. i datës 13.12.2019; E-mail nga M.H. për A.A. i datës 13.12.2019; Ankesë me nr. 1364 e datës 04.12.2019; Vërtetim i datës 25.04.2018; Vërtetim për G.S.; Certifikata e notave e datës 28.06.2016; Formulari i vleresimit të temës së Masterit i datës 25.04.2018; Certifikata e notave e datës 25.04.2018; Formulari i vleresimit të temës së Masterit i datës 25.04.2018; Formulari i vleresimit të temës së Masterit i datës 25.04.2018; E-mail nga G.S. për M.N. i datës 23.04.2018; E-mail i datës 28.04.2018; E-mail i datës 20.04.2017; E-mailat e datës 01.07.2016; Vendim me nr. 1393 i datës 13.03.2018; Vendim i datës 07.04.2017; Akt Emërimi i datës 07.08.2019; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Ankesë me nr. 357 e datës 18.02.2020; Procesverbal i datës 25.02.2020; Procesverbal i datës 25.02.2020; Procesverbal i datës 25.02.2020; Procesverbal i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 19.02.2020; Procesverbal i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 16.03.2020; Vendim me nr. 3414 i datës 20.12.2019; Procesverbal i datës 10.01.2020; Procesverbal i datës 26.12.2019; Procesverbal i datës 10.01.2020; Akt vendim i datës 25.04.2018; Vërtetim i datës 25.04.2018; Vërtetim i datës 04.04.2018; Formular për lejimin e punimit të temës Master i datës 30.06.2016; Njoftim për mbrojtjen e temës Master i datës 25.04.2018; Akt Vendim i datës 16.03.2017; Vendim me nr. 1603 i datës 30.03.2018; Akt Vendim i datës 25.11.2016;

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses

është e bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës rezultoi se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës Zyrtare për Master dhe Doktoraturë në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë. Në kohën e nxjerrjes së vendimit të kontestuar dhe rrjedhimisht parashtrimin të ankesës ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku sipas dispozitave të këtij ligji parashtruesja e ankueses ka pasur statusin e nëpunësit civil. Kolegji, bazuar në këtë gjendje faktike dhe bazë juridike, konstatoi ekzistimin e kompetencës lëndore dhe shqyrtoj pretendimet ankimore të ankueses

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Komisioni Disiplinor pranë Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, përmes Vendimit Nr.098 të datës 23.01.2020 ka konstatuar se ankuesja si rezultat i neglizhencës në punë ka dështuar t'i përmbush obligimet e saj zyrtare në rastin kur ka pranuar që dosjen e pakompletuar të studentit G.S, t'ia japë mentorit të tij, njeherit Prodekan i Fakultetit të Biznesit në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, dhe rrjedhimisht të njëjtës i ka shqiptuar masën disiplinore *Pezullim i ushtrimit të detyrave dhe ndalimi i 1/3 të pagës për muajin shkurt dhe mars 2020.*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 12 ku përcaktohet se: *Nëse udhëheqësi i drejtpërdrejtë konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë-serioze në afat prej 2 dite pune do ta paraqes rastin me shkrim të udhëheqësi i njësisë së personelit, dhe rrjedhimisht duke u bazuar në shkresat e administruara të lëndës ka konstatuar se procedura disiplinore nuk është iniciuar në pajtim me këtë dispozite ligjore sepse inicimi i procedurës disiplinore është bërë me datë 12.12.2019 nga Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, dhe jo nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, gjegjësisht Sekretari i Fakultetit të Biznesit. Kolegji në shkresa të lëndës nuk ka gjetur dëshmi se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses paraprakisht ka vlerësuar rastin dhe ka konstatuar se ankuesja ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës, me ç'rast do të plotësohet kushti ligjor për procedim të rastit në njësinë e personelit për të vazhduar me procedura disiplinore, andaj, bazuar në këtë konstatim Kolegji vlerëson se inicimi i procedurës disiplinore nuk është bërë në përputhje me dispozitat e Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.*

Përveç lëshimeve procedurale, organi i punësimit, gjegjësisht Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokoll 098 të datës 23.01.2020 për shqyrtimin e masës disiplinore ndaj ankueses nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, sepse nuk ka marrë për bazë faktin se ankuesja ka vetëm përgjegjësi administrative dhe në mungesë të komunikimit me shkrim nga mentori i studentit ka munguar informacioni nëse dosja është kërkuar për qëllim të mbrojtjes së temës së masterit apo nevoja tjera për çka mentori i studentit mund të ketë qasje.

Kolegji, në shkresa të lëndës ka gjetur formularin lidhur me listën kontrolluese për studentet e studimeve master para diplomimit, e cila përveç tjerash përmban saktësinë e dokumenteve, të cilat duhet t'i përmbaj dosja e studentit para diplomimit. Andaj, Kolegji vlerëson se ky dokument i aprovuar nga vetë organi i punësimit duhet t'i shërbej Komisionit për Mbrojtjen e Temave të Diplomës si dokument përmes të cilit shihet nëse dosja e studentit është e kompletuar, dhe vetëm atëherë duhet t'i lejohet studentit mbrojtja e temës së masterit. Në rastin e studentit G.S, formulari lidhur me listën kontrolluese nuk ka qenë i plotësuar dhe organi i punësimit nuk ka sjellë dëshmi ku do të konstatohet se studenti G.S ka përfunduar pagesat me rregull por për shkak të neglizhencës së

ankueses të njëjta nuk janë përfshi në dosjen e studentit. Andaj, në mungesë të këtyre provave, gabimisht është konstatuar gjendja faktike me rastin e shpalljes përgjegjëse të ankueses, sepse ankuesja nuk ka mundur të plotësojë dosjen e studentit me të dhëna të cilat nuk janë sjellë nga studentit, gjegjësisht fletëpagesat për të cilat nuk janë paguar nga studentit, siç kërkohet me rregulloret e brendshme të Universitetit.

Komisioni Disiplinor me rastin e përcaktimit të përgjegjesisë disiplinore ndaj ankueses, përveç se nuk ka konstatuar drejte gjendjen faktike, nuk ka zbatuar drejtë as ligjin material sepse me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 098 të datës 23.01.2020 vetëm ka konstatuar se ankuesja ka bërë shkelje disiplinore pa specifikuar, gjegjësisht kualifikuar shkeljen disiplinore siç përcaktohet me Rregulloren Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.627 të datës 16.03.2020 për refuzimin e ankesës ka dështuar të konstatojë drejtë gjendjen faktike duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.989/2021.

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë;
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

